

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

NJOFTIM PER INFORMATA SHTESE

ose

PERMIRESIM I GABIMIT

Sipas Nenit 53 të Ligjit Nr. Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92

Punë

Furnizim

Shërbime

[Përkujtese: Nëse ndonjë përmirësim i gabimit ose informacion shtese shpije ne një ndryshim rrënjësor të kushteve të parashikuara në njoftimin origjinal te kontratës me një influencë mbi parimin e trajtimit të barabartë dhe në objektivin e prokurimit konkurrues, do të jetë e nevojshme zgjatja e afateve fillimisht te parapara]

Data e përgatitjes te këtij njoftimi: 06.12.2023

Nr i Prokurimit	616-23-13568-5-1-1
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES		
Adresa Postare: TREPQES NR.2		
Qyteti: PRISHTINË	Kodi postar: -	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Gezim Restelica		Telefoni: 038 244 613
Email: gezim.restelica@rks-gov.net prokurimi.prishtine@rks-gov.net		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: (ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)

Renovimi artistik dhe infrastrukturor i tunelit te kurrizit „Dardani

<p>II.1.2) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës <i>(ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)</i> Renovimi artistik dhe infrastrukturor i tunelit te kurrizit „Dardani”, sipas pershkrimit teknik te dhene ne dosjen e tenderit</p>
<p>II.1.3) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): <i>(ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)</i> 45110000-1</p>

NENI III: PROCEDURA

III.1) LLOJI I PROCEDURËS

III.1.1) Lloji i procedurës <i>(ashtu siç është përcaktuar ne njoftimin origjinal te kontratës)</i>
<input checked="" type="checkbox"/> E hapur
<input type="checkbox"/> E kufizuar
<input type="checkbox"/> Konkurruese me negociata
<input type="checkbox"/> Kuotim i çmimit

III.2) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

III.2.1) Data e publikimit të njoftimit origjinal të kontratës:
--

NENI IV: INFORMACIONET PLOTËSUESE

IV.1) KY NJOFTIM PERFSHINE		
Përmirësim <input checked="" type="checkbox"/>	Informata shtesë <input type="checkbox"/>	
Njoftim për kontrate <input checked="" type="checkbox"/>	Njoftim për dhënie kontrate <input type="checkbox"/>	
IV.2) INFORMACIONI QE DUHET TE PERMIRESOHER OSE TE SHTOHET <i>(nëse aplikohet; te specifikohet vendi i tekstit ose datat te cilat duhet te përmirësohen apo te shtohen, ju lutem gjithmonë ofroni nenet përkatëse & numrin e paragrafit te njoftimit origjinal)</i>		
IV.2.1) Modifikimi i informatave origjinale të dorëzuara nga Autoriteti Kontraktues <input checked="" type="checkbox"/>	Publikimi në webfaqen e KRPP-së nuk është në përputhje me informatat origjinale të dorëzuara nga Autoriteti Kontraktues <input type="checkbox"/>	Të dyja <input type="checkbox"/>
IV.2.2) Në njoftimin origjinal <input type="checkbox"/>	Në dokumentet e tenderit <input type="checkbox"/>	Të dyja <input checked="" type="checkbox"/>
IV.2.3) Teksti i cili duhet të përmirësohet/shtohet në njoftimin origjinal <i>(nëse aplikohet)</i>		
Vendi i tekstit i cili duhet të modifikohet:	Në vend të:	Është :

Afati i fundit për pranim të tenderëve	25.01.2024 14:00:00	06.02.2024 14:00:00
Takimi për hapjen e tenderëve	25.01.2024 14:00:00	06.02.2024 14:00:00
Kërkesat e përshtatshmërisë	<p>1.Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http://krpp.rksgov.net, 1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohej kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohej origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit</p>	

	<p>Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dytë.</p>
Përshtatshmëria profesionale	<p>1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit për ushtrimin e veprimtarisë, 1.Kopja e Certifikatës se biznesit</p>
Përshtatshmëria profesionale	<p>2.Certifikata e numrit fiskal-Numri Unik Identifikues, 2.Kopja e Certifikatës se numrit fiskal-Numri Unik Identifikues</p>
Kapaciteti ekonomik dhe financiar	<p>1.Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 1,500.000,00 euro., 1.Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur.</p>
Kapaciteti teknik dhe profesional	<p>1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 1,235,000.00 €, 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes së Tenderit ti bashkëngjiten</p>

	<p>referencat ose certifikatat për kryerje te puneve , nese kontrata eshte me kompani private te deshmohet me transaksion bankar (deshmi qe eshte kry pagesa).</p>
<p>Kapaciteti teknik dhe profesional</p>	<p>2.OE duhet të prezentoj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt si ne vijim</p> <p>a) Menaxheri i projektit duhet të jetë Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë drejtimi - konstruktiv - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit.</p> <p>b) Një (1) Inxhinier i Diplomuar i Arkitektures min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit.</p> <p>c) Një (1) Inxhinier i Diplomuar i hidroteknikës me së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit.</p> <p>d) Një (1) Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikes - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit.</p> <p>e) Një (1) Inxhinier i Diplomuar i makinerisë - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit.</p> <p>f) Së paku 15 punëtor për kryerjen e punëve në teren., 2.Për piken a -e OE të ofroj dëshmi kopjen e diplomës universitare të noterizuar nga origjinali (noterizimi të mos jetë më i vjetër se 30 ditë nga data e njoftimit për kontratë) apo nëse OE i ka të regjistruar në listën e pagave në Administratën Tatimore të Kosovës nuk ka nevojë të noterizohen, CV-ja, kontrata valide kopje ose marrëveshje për angazhim në këtë projekt me punëdhënësin, nëse prezantoni marrëveshje për këtë projekt atëherë marrëveshja duhet të jetë kopje e noterizuar nga origjinali si dhe referencat per pervojen e punes . AK rezervon të drejtën që me rastin e zgjedhjes së fituesit nëse e sheh të nevojshme të kërkojë verifikimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara. f)</p>

	<p>Lista e punetoreve dhe kontratat e punës me punedhënesin ose marreveshje për angazhim në këtë projekt.</p>
Kapaciteti teknik dhe profesional	<p>3. Operatori Ekonomik duhet të posedoj certifikatat ISO STANDARD si në vijim a)ISO 14001 2015 dhe b) ISO 45001 2018,c) ISO 9001-2015, 3. Kopje e Certifikatave ISO 14001 2015, ISO 45001 2018 , ISO 9001-2015</p>
Kapaciteti teknik dhe profesional	<p>4.OE duhet të jetë i pajisur me dokumentacionin Operatorët Ekonomik duhet të dëshmojë sipas kërkesave të ligjit 04 L-161 për Siguri dhe Shëndet në Punë, 4.Operatorët Ekonomik duhet të dëshmojë raportin e vlerësimit të riskut për të gjitha pozitën e organogramit dhe organizimit të kompanisë nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale</p>
Kapaciteti teknik dhe profesional	<p>5.Autorizimi nga prodhuesi për figurat 16,17, 18, 22, 37, 38, 40, 52, 53., 5.Autorizimi nga Prodhuesi</p>
Kapaciteti teknik dhe profesional	<p>6.Katalogu me specifika për figurat 16,17, 18, 22, 37, 38, 40, 52, 53, 6. Katalogu i nënshkruar dhe vëlosur .</p>
Kapaciteti teknik dhe profesional	<p>7.Garancioni deklarativ nga OE- për 2 vite për figurat 4, 6, 7, 8, 16, 17, 18, 22, 37, 38, 40, 52, 53., 7. Deklarate për garancion e nënshkruar dhe e vëlosur.</p>
Kapaciteti teknik dhe profesional	<p>8.Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit ; Aneksin 7 të DT., 8.OE duhet të plotësojë dhe dorëzojë listën e pajisjeve duke plotësuar Aneksin 7 duke i bashkangjitur librezat valide.Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmojë me marrëveshje të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit.</p>
Kapaciteti teknik dhe profesional	<p>9.OE duhet të dorëzojë mostrat sipas specifikimeve teknike për figurat 4, 6, 7, 8, 16, 17, 18, 22, 37, 38, 40, 52, 53.,</p>

	9. Mostrat duhet te dorëzohen në sportelet për dhënë për shërbim me qytetarë në ditën e hapjes së ofertave më 25.01.2024 deri para hapjes së ofertave.

----- (Shtojnë nën IV.2.3 sa këtu që këtu duhet) -----